


INVESTITOR
“ENEX GROUP” SH.P.K.
Gllaviçicë - Pejë



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIANTIN E
PËRPUNIMIT, THËRRMIMIT DHE SEPERIMIT E RËRËS DHE
ZHAVORRIT, GLLAVIÇIÇË, KOMUNA E PEJËS**

Qërshor - 2025

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PËRPUNIMIN,
THËRRMIMIN DHE SEPERIMIN E RËRËS DHE ZHAVORRIT
“ ENEX GROUP ” SH.P.K.**

Parcela me numër P - 71611018 - 00253 - 0, Zona kadastrale Gllaviçicë , Komuna e Pejë

Investitori:	“ENEX GROUP”SH.P.K.
Personi i Autorizuar:	Eris Kelmendi
Adresa:	Zahaq-Sverkë, pn
Lokacioni:	Gllaviçicë - Pejë
Tel:	+383 49 – 467 - 003
Email:	enexgroupshpk@gmail.com

Hartuese e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Emri:	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Email:	Blerinabajraktari1@gmail.com Blerinabajraktari3@gmail.com
Tel:	+383 49 588 634
Nr. i Licencës:	07/20

“ENEX GROUP” SH.P.K.

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari


Nënshkrimi dhe Vula


Nënshkrimi

Qërshor – 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	2
3.	VENDNDODHJA E IMPIANEVE PËR PERPUNIM, THËRMIM DHE SEPERIMIN E RËRËS DHE ZHAVORIT	3
3.1	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	6
3.2	Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative	7
3.3	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	9
3.5	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit	14
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT, THËRRMIMIT DHE SEPERIMIN E RËRËS DHE ZHAVORRIT	15
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	17
5.1.	Flora dhe Fauna.....	17
5.2.	Klima dhe Temperatura.....	18
5.3.	Karakteristikat Hidrografike	18
5.4.	Lagështia Relative e Ajrit.....	20
5.5.	Vrantësimi dhe diellosja.....	20
5.6.	Të reshurat	20
5.7.	Era.....	20
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	21
6.1	Ndikimet në ajër	21
6.2	Ndikimet në tokë.....	22
6.3	Ndikimet në ujë.....	22
6.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	23
6.5	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	23
6.6	Ndikimet nga zhurma.....	24
6.7.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	25
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	26
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	27
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS	29
9.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	29
9.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	29
9.3.	Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë	30
9.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma.....	31
9.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	31
9.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	32
9.7.	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	32
9.8.	Menaxhimi i mbeturinave	33
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	34
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	34

12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	35
12.1. Ndikimet Mjedisore dhe Masat Zbutëse	35
12.3. Përfitimet.....	36
13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE	37
14. LITERATURA E PERDORUR	38

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1.Shktrirja hapësinore e lokacionit të impianteve për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit.....	3
Figura 2 Distanca e lokacioni të Impianteve për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit	3
Figura 3 Lokacioni i Impianeve të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit	4
Figura 4. Distanca e impianteve për përpunimin, thërrmimit, seperimin e rërës dhe zhavorrit me objekte idustiale	5
Figura 5. Distanca e Impiantit për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit me lumin	5
Figura 6. Procesi teknologjik i përpunimit, thërrmimit, seperimin e rërë dhe zhavorrit	12
Figura 7. Pamja 3D e thërrmuesit me nofull	12
Figura 8.Thërrmusja rotative me greda.....	13
Figura 9. Thërrmusja konike.....	13
Figura 10. Sita e pjerrët vibruse dhe sita mobile	13
Figura 5. Të Dhënat Klimatologjike për Rajonin e Pejës	18
Figura 6. Rrjeti Hidrografik i komunës se Pejës.....	19

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1 Tabela e madhësisë se fraksioneve te prodhuara nga përpunimi, thërrmimi dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit.....	8
Tabela 2 Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës.....	24
Tabela 3 Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror	33

1. HYRJE

Bazuar në nenin 11 dhe Shtojcën 4 të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe për të përmbushur kërkesat ligjore për ndërtimin dhe operimin e impianteve për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, kompania “ENEX GROUP” SH.P.K., me seli në Komunën e Pejës, ka filluar përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).

Ky raport është hartuar për të vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore që mund të shkaktohen nga ndërtimi dhe funksionimi i impianteve për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, të cilat planifikohet të ndërtohen në fshatin Gllaviçicë, Komuna e Pejës. “ENEX GROUP” SH.P.K., e themeluar në vitin 2023, synon të zhvillojë këtë projekt industrial në parcelën kadastrale me numër P-71611018-00253-0, e cila gjendet në zonën kadastrale të Gllaviçicës në komunën e Pejës. Ky raport paraqet një dokument të domosdoshëm për sigurimin e Pëlqimit Mjedisor, duke identifikuar dhe analizuar ndikimet potenciale në mjedis dhe duke përcaktuar masat mbrojtëse të nevojshme për minimizimin ose eliminimin e tyre gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit.

Ky dokument përfshin:

- Analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e planifikuar, duke përfshirë faktorët ekologjikë dhe socio-ekonomikë;
- Përshkrimin e karakteristikave teknike të impiantit dhe proceseve industriale të planifikuara;
- Vlerësimin e ndikimeve mjedisore që mund të rezultojnë nga aktivitetet e ndërtimit dhe operimit.

Ky raport synon përkufizimin e ndikimeve potenciale dhe përcaktimin e masave efektive për minimizimin ose eliminimin e tyre gjatë fazave të realizimit dhe operimit të impianteve. Gjatë hartimit të tij, janë marrë parasysh standardet mjedisore dhe masat për zvogëlimin e ndikimeve negative. Ky raport paraqet një dokument kyç për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të aktivitetit industrial dhe për përmbushjen e të gjitha kërkesave ligjore dhe mjedisore të nevojshme për realizimin e projektit.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Bazuar në karakteristikat e impianteve të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas gjendjes ekzistuese (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili është bazë kryesore ligjore ku jemi referuar.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr.08/L-181
- Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina,
- Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikoj për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. VENDNDODHJA E IMPIANEVE PËR PERPUNIM, THËRRMIM DHE SEPERIMIN E RËRËS DHE ZHAVORIT

Implantet e përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit i cili përfshin të gjitha pajisjet përcjellëse, do të vendoset në ngastrën kadastrale me numrin P – 71611018 – 00253 - 0 që gjendet në zonën kadastrale të Gllaviçicë, në komunën e Pejës.




Figura 1. Shkëlqim hapësiror e lokacionit të impianteve për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit




Figura 2 Distanca e lokacioni të Impianteve për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit

Distanca midis lokacionit të impianteve për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit dhe qendrës së Komunës së Pejës është përafërsisht 13.6 kilometra larg. Në afërsi të zonës ku janë ndërtuar impiantet, ndërtesat e banimit më të afërta ndodhen në një distancë prej rreth 368.21 metrash nga perimetri i kompleksit industrial.




Figura 3 Lokacioni i Impianeve të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit

Në rrezen e afërt të parcelës ku planifikohet ndërtimi i impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, ndodhen disa objekte me destinim industrial që ushtrojnë veprimtari të ngjashme me atë të propozuar. Objekti industrial më i afërt gjendet në një distancë prej 285.12 metrash nga kufiri i parcelës, ndërsa të tjerët janë të shpërndarë në perimetrin përreth.




Figura 4. Distanca e impianteit për përpunimin, thërrmimit, seperimin e rërës dhe zhavorrit me objekte idustiale

Në afërsi të lokacionit të planifikuar nuk gjendet asnjë zonë e mbrojtur mjedisore. Megjithatë, në një distancë prej 166.18 metrash nga impianti, ndodhet Lumi Lumbardhi i Pejës, i cili përbën një element të rëndësishëm hidrografik në rajon.



Figura 5. Distanca e Impiantit për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërës dhe zhavorrit me lumën


3.1 Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Projekti i ndërtimit të impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit është planifikuar të realizohet në parcelën kadastrale me numër **P-71611018-00253-0**, e cila ndodhet në zonën kadastrale të **Gllaviçicës**, Komuna e Pejës. Parcela e përzgjedhur për projektin ndodhet **3.2 km larg qytetit të Pejës**, duke ofruar një pozitë strategjike për akses në rrugët kryesore rajonale dhe lidhje të lehtë logjistike për transportin e lëndës së parë dhe të produkteve finale. Vendndodhja karakterizohet nga një terren kryesisht i rrafshët, që e bën të përshtatshëm për ndërtimin e infrastrukturës industriale dhe instalimin e pajisjeve teknologjike. Për më tepër, zona përreth është e destinuar për aktivitete industriale dhe nuk përmban zona të mbrojtura mjedisore, as elemente natyrore me vlera të veçanta ekologjike, gjë që minimizon konfliktet potenciale me përdorimet e tjera të tokës.

1. Struktura dhe komponentët teknologjikë

Impianti është projektuar si një linjë teknologjike e integruar që përfshin komponentët kryesorë dhe ndihmës:

- **Bunkeri i pranimit të materialit (Poz. 01):** Me kapacitet **10 m³**, i cili shërben për grumbullimin dhe ruajtjen e materialit të papërpunuar.
- **Transportuesi horizontal dhe transportuesi i pjerrët (Poz. 02 dhe Poz. 03):** Përdoren për transferimin e materialit drejt pajisjes së sitjes.
- **Sita me pesë fraksione granulometrike (Poz. 04):** Ndarja e agregateve në fraksione të specifikuar:
 - 0–4 mm
 - 4–8 mm
 - 8–16 mm
 - 16–31.5 mm
 - 31.5 mm
- **Elevatori rotork me kova (Poz. 05):** Për transportimin vertikal të agregateve.
- **Transportuesit për fraksionet e ndara (Poz. 06–10):** Bartin materialet e klasifikuara drejt zonave të depozitimit.
- **Tabela komanduse e separacionit (Poz. 11):** Njësia për menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë procesit teknologjik.
- **Pompa e ujit (Poz. 12):** Me fuqi **18.5 kW**, për larjen e agregateve dhe reduktimin e pluhurit.
- **Trafostacioni elektrik (Poz. 13):** Siguron energjinë elektrike të nevojshme për funksionimin e impiantit me kapacitet **250 kVA**.



2. Infrastruktura ndihmëse

Përveç pajisjeve teknologjike, projekti përfshin ndërtimin e:

- **Rrugëve të brendshme dhe zonave të manovrimit** për mjetet transportuese.
- **Hapësirave të depozitimit të agregateve të klasifikuara.**
- **Sistemit të menaxhimit të ujërave të përdorura** për mbrojtjen e mjedisit përreth.

3. Kapacitetet teknike dhe operacionale

Impianti ka një kapacitet përpunimi prej **60 m³/h**, i cili është projektuar për të operuar në mënyrë të qëndrueshme dhe me efikasitet të lartë energjetik. Teknologjia e instaluar është e zgjedhur për të minimizuar emetimet e pluhurit dhe për të përmbushur standardet më të larta të mbrojtjes së mjedisit.

3.2 Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative

Faza operative e implantit të sepërimit të rërës dhe zhavorrit përfshin një sërë veçorish dhe procese që sigurojnë funksionimin efikas dhe efektiv të implantit. Kjo fazë përfshin gjithë proceset që lidhen me marrjen, përpunimin dhe ndarjen e materialeve të papërpunuara deri në prodhimin e materialeve të gatshme, si dhe mbikëqyrjen e performancës dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Veçoritë Kryesore të Fazës Operative:

a. Pranimi dhe Inspektimi i mbetjeve nga rëra dhe zhavorri

Inspektimi Fillestar: Rërës dhe zhavorri do të blehet nga kompanit tjera dhe me pasë do të inspektohen për të siguruar që ato janë të përshtatshme për përpunim dhe sepaerim dhe nuk përmbajnë materiale të rrezikshme apo kontaminuese.

b. Thërrmimi dhe seperimi

Thërrmimi: Materiali i pranuar do të kalojnë nëpër makineritë e thërrmimit për të reduktuar madhësinë e tyre dhe për të përgatitur materialet për procesin e mëtejshëm të ndarjes.

Seperimi: Materialet e thërrmuara do të kalojnë nëpër pajisje të specializuara për ndarjen e materialeve bazuar në përbërjen dhe madhësinë e tyre.

Ndarja do te behet në fraksione:

Tabela 1 Tabela e madhësisë së fraksioneve të prodhuara nga përpunimi, thërrmimi dhe seperimi i rërës dhe zhavorrit

Nr.	Fraksionet	Granulometria (mm)
1.	I	0 – 4 (mm)
2.	II	4 - 8 (mm)
3.	II	8 – 16 (mm)
4.	IV	16 – 31.5 (mm)

a) Depozitimi dhe Magazinimi

Depozitimi i materialit të përpunuar: Materialet e rërës dhe zhavorrit do të depozitohen në hapësira të dedikuara për magazinimin e fraksioneve.

b) Transporti dhe Shitja

Transporti i materialit: Materialet e seperuara do të ngarkohen në automjete të përshtatshme për transport dhe do të dërgohen tek klientët, përfshirë ndërtuesit, rrugët dhe kompani të tjera që përdorin rëre dhe zhavorr.

Marketingu dhe Shitjet: Impianti do të ketë një ekip të dedikuar për marketingun dhe shitjen e produkteve të rërës dhe zhavorrit.

c) Menaxhimi i Mbeturinave dhe Efikasiteti Operativ

Menaxhimi i Mbeturinave: Gjatë procesit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit, do të krijohen disa mbeturina të cilat do të menaxhohen në mënyrë të përgjegjshme.

Efikasiteti Operativ: Për të siguruar një operim të qëndrueshëm dhe efikas, impianti do të përdorë teknologji me te reja dhe moderne dhe praktika të mira menaxheriale. Kjo përfshin përdorimin e sistemeve të avancuara për monitorimin e procesit, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe trajnimin e rregullt të stafit.

d) Masat e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Siguria e Punëtorëve: Puna në impiant do të kryhet duke respektuar të gjitha rregulloret e sigurisë në punë. Punëtorët do të pajisen me pajisje mbrojtëse personale (PPE) dhe do të ndjekin procedurat e sigurta të punës.

Mbrojtja e Mjedisit: Impianti do të zbatojë masat për minimizimin e ndikimit në mjedis, përfshirë përdorimin e sistemeve të filtrimit të ajrit për të reduktuar ndotjen dhe menaxhimin e duhur të ujërave të përdorura. Përpjekje të vazhdueshme do të bëhen për të përmirësuar efikasitetin energjetik dhe për të reduktuar mbetjet e pa riciklueshme.

e) Trajnimi dhe Zhvillimi i Stafit

Trajnime të Rregullta: Stafi do të marrë trajnime të rregullta për të siguruar njohuri dhe aftësi të përditësuara në lidhje me teknologjitë e reja dhe praktikatat më të mira në industrinë minerare.

Zhvillimi Profesional: Investime në zhvillimin profesional të stafit për të ngritur nivelin e shërbimit dhe për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të impiantit.

Këto veçori kryesore të fazës operative të impiantit të përpunimit, thërmimit dhe separimit të rërës dhe zhavorrit sigurojnë një proces të qëndrueshëm, efikas dhe miqësor me mjedisin, duke mbështetur qëllimin për të minimizuar mbetjet dhe për të promovuar ri-përdorimin e materialeve në sektorin e ndërtimit dhe infrastrukturës.

f) Lënda e parë dhe lënda ndihmëse

Lënda e parë janë rëra dhe zhavorri, ndërsa si lende kryesore ndihmëse do të jete energjia elektrike dhe uji për uljen e ndotjes nga pluhuri.

3.3 Përshkrimi detaj i procesit teknologjik

Procesi teknologjik i impiantit për përpunimin, thërmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit realizohet përmes një linje teknologjike të ndërtuar nga pajisje të specializuara që mundësojnë përpunimin e materialit nga faza e pranimit deri te prodhimi final i fraksioneve të klasifikuara.

1. Bunkeri i rërës dhe zhavorrit (Poz. 01)

Ky bunker, me një kapacitet prej 10 m³, shërben si pika fillestare e procesit teknologjik. Ai është projektuar për të grumbulluar dhe ruajtur materialin e papërpunuar (rërë dhe zhavorr) që transportohet me mjete të specializuara nga zona e nxjerrjes. Bunkeri ka një konstruksion të përshtatshëm për mbrojtjen e materialit ndaj kushteve atmosferike dhe për të garantuar një rrjedhë të vazhdueshme dhe uniforme të lëndës së parë drejt pajisjeve të tjera të linjës teknologjike. Përveç kësaj, ai minimizon rrezikun e bllokimeve dhe krijon një rezervë operationale që lehtëson punën e pajisjeve pasuese.

2. Transportuesi horizontal mbledhës – Dozatori (Poz. 02)

Kjo pajisje është një komponent kyç për sigurimin e materialit të qëndrueshëm të linjës së përpunimit. Funksioni i saj kryesor është të mbledhë materialin nga bunkeri dhe ta shpërndajë atë në mënyrë të njëtrajtshme drejt fazës tjetër të procesit. Dozatori është i pajisur me mekanizma të rregullimit të rrjedhës së materialit, duke mundësuar kontroll të plotë mbi sasinë e lëndës së parë që futet në linjë. Ky kontroll është i domosdoshëm për të siguruar një përpunim efikas dhe për të shmangur mbingarkesën e pajisjeve pasuese.

3. Transportuesi i pjerrët furnizues i agregatit (Poz. 03)

Transportuesi i pjerrët është projektuar për të ngritur materialin e papërpunuar nga niveli i ulët i bunkerit drejt nivelit të lartë ku ndodhet sita me pesë granulata. Kjo pajisje siguron një rrjedhë të pandërprerë të materialit dhe shmang humbjen e lëndës gjatë transferimit vertikal. Dizajni i tij është i përshtatur për të përballuar ngarkesa të mëdha dhe për të operuar në mënyrë të qëndrueshme edhe në kushte intensive pune.

4. Sita me pesë granulata (Poz. 04)

Sita përbën një element thelbësor të procesit teknologjik, pasi realizon ndarjen granulometrike të aggregateve sipas madhësisë së kokrrizave. Ajo klasifikon materialin në pesë fraksione të ndryshme:

- **0–4 mm**
- **4–8 mm**
- **8–16 mm**
- **16–31.5 mm**
- **>31.5 mm**

Pajisja është e pajisur me sisteme vibruese që mundësojnë ndarjen efikase dhe eliminimin e mbetjeve të padëshiruara. Për më tepër, ajo minimizon ndotjen e ambientit përreth duke integruar sisteme për reduktimin e pluhurosjes gjatë procesit të sitjes.

5. Elevatori rotork me kova (Poz. 05)

Ky elevator është projektuar për transportimin vertikal të fraksioneve të klasifikuara ose të materialeve që kërkojnë përpunim të mëtejshëm. Ai përbëhet nga një seri kovash të montuara mbi një zinxhir ose rrip që lëviz në mënyrë të vazhdueshme. Funksioni i tij është të sigurojë kalimin pa humbje të materialit nga një nivel në tjetrin brenda linjës teknologjike.

6. Transportuesit për fraksionet e ndara (Poz. 06–10)

Për secilin fraksion të materialit të klasifikuar ekziston një transportues i dedikuar, i cili shërben për bartjen e aggregateve në zonat përkatëse të depozitimit:

- **Transportuesi për granulatin 0–4 mm (Poz. 06)**
- **Transportuesi për granulatin 8–16 mm (Poz. 07)**

- Transportuesi për granulatin 16–31.5 mm (Poz. 08)
- Transportuesi për granulatin >31.5 mm (Poz. 09)
- Transportuesi për granulatin 4–8 mm (Poz. 10)

Këto transportues janë projektuar për të garantuar rrjedhshmëri dhe shmangien e ndotjes së kryqëzuar midis fraksioneve të ndryshme.

7. Tabela komanduse e separacionit (Poz. 11)

Ky është qendra e kontrollit të linjës teknologjike, nga e cila monitorohet dhe menaxhohet funksionimi i të gjitha pajisjeve. Tabela komanduse është e pajisur me sisteme të automatizuara që lejojnë operatorët të përcaktojnë parametrat operativë, të diagnostikojnë problemet dhe të optimizojnë procesin teknologjik në kohë reale.

8. Pompa e ujit (Poz. 12)

Pompa e ujit, me fuqi $P = 18.5$ kW, luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e pluhurosjes dhe pastrimin e agregateve gjatë fazave të sitjes dhe transportit. Sistemi i saj mundëson spërkatjen e vazhdueshme të materialit për të minimizuar emetimet e grimcave të imëta dhe për të përmirësuar cilësinë e produktit përfundimtar.

9. Trafostacioni elektrik (Poz. 13)

Trafostacioni me kapacitet **250 kVA** siguron furnizimin me energji elektrike për të gjithë sistemin teknologjik. Ai është projektuar për të garantuar një rrjedhë të qëndrueshme dhe për të përballuar ngarkesat e larta energjetike që kërkohen nga pajisjet gjatë operimit të vazhdueshëm.

Tabela 2 Tabela e pozicioneve të Seperacionit me thërrmues

13	1	copë	Trafo elektrike, 10/0.4 [kV] me fuqi 250 [kVA]
12	1	copë	Pompa e ujit me fuqi $P = 18.5$ [kW]
11	1	copë	Tabela komanduese e separacionit
10	1	copë	Transportieri i pjerrët i granulitit: 4 - 8 [mm]
09	1	copë	Transportieri i pjerrët i granulitit: >31.5 [mm]
08	1	copë	Transportieri i pjerrët i granulitit 16 - 31.5 [mm]
07	1	copë	Transportieri i pjerrët i granulitit 8 - 16 [mm]
06	1	copë	Transportieri i pjerrët i granulitit: 0 - 4 [mm]
05	1	copë	Elevatori rotorik me kova
04	1	copë	Sita vibruese me 5 granulate
03	1	copë	Transportieri i pjerrët furnizues i agregatit
02	1	copë	Transportieri horizontal mbledhës - Dozatori
01	1	copë	Bunkeri i rërës dhe zhavorit - hinka pranuese me vëllim $V = 10$ [m ³]




Figura 6. Seperacioni me thërrmues për përpunimin, thërrmimin, seperimin e rërë dhe zhavorrit

Thërrmimi kryhet përmes disa pajisjeve që mundësojnë reduktimin gradual të madhësisë së grimcave:

- **Thërrmuesit me nofulla:** përdoren për thërrmimin primar të gurëve të mëdhenj. Procesi realizohet duke shtypur materialin midis dy sipërfaqeve, njëra fikse dhe tjetra e lëvizshme.




Figura 7. Pamja 3D e thërrmuesit me nofull

- **Thërrmuesit me greda:** përpunojnë materialin pas thërrmimit primar, duke reduktuar madhësinë e grimcave dhe përgatitur ato për sitje.



Figura 8. Thërrmusja rotative me greda

- **Thërrmuesit konikë:** përdoren për thërrmimin terciar, për të arritur granulometrinë e dëshiruar dhe përmirësimin e cilësisë së agregatit.




Figura 9. Thërrmusja konike

Procesi i sitjes dhe klasifikimit

Pas thërrmimit, materialet kalojnë nëpër sistemin e sitave vibruese dhe rrotulluese .



Figura 10. Sita e pjerrët vibruse dhe sita mobile

- **Sitat vibruese të pjerrëta:** kryejnë klasifikimin fillestar dhe largojnë fraksionet e papërshtatshme.
- **Sitat rrotulluese dhe të lëkundshme:** ofrojnë një ndarje të imët të materialeve dhe pastrim të aggregateve nga mbeturinat e vogla.

3.5 Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit

Projekti i planifikuar nga kompania “ENEX GROUP” SH.P.K., që parasheh ndërtimin e një impianti modern për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit në parcelën kadastrale **P-71611018 - 00253-0**, zona kadastrale **Gllaviçicë**, Komuna e Pejës, përfshin gjithashtu ndërtimin e një sistemi sedimentues për trajtimin e ujërave të ndotura. Ky sistem është i dizajnuar për të minimizuar ndikimin potencial të ujërave teknologjike në mjedisin përreth dhe për të rikuperuar ujin për përdorim të mëvonshëm brenda impiantit.

➤ Ajri

Proceset e planifikuara të përpunimit, thërrmimit dhe separimit do të gjenerojnë ndotës të ajrit si:

- **Pluhur (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$):** Gjenerohet gjatë thërrmimit të aggregateve, sitjes dhe lëvizjes së mjeteve transportuese.
- **Gazrat Serë (CO_2 , CH_4 , N_2O):** Emetohen nga makineritë e rënda dhe pajisjet që përdorin lëndë djegëse.
- **Emetime të tjera (NO_x , CO , HC):** Të lidhura me funksionimin e pajisjeve teknologjike.

➤ Uji

Kompania ka paraparë ndërtimin e sedimentuesve për trajtimin e ujërave të ndotura që do të gjenerohen gjatë operimit të impiantit. Ky sistem do të shërbejë për:

- Sedimentimin e grimcave të ngurta nga uji teknologjik i përdorur në larjen e aggregateve dhe spërkatjen e zonave manipuluese.
- Reduktimin e ngarkesës së pezulluar (TSS) dhe rikuperimin e ujit për përdorim të brendshëm.

➤ Toka

Ndikimet në tokë janë të kufizuara dhe kryesisht të përkohshme gjatë fazës së ndërtimit. Gjatë operimit, sistemi i kanalizimit dhe sedimentuesit do të kontrollojnë rrjedhjen e ujërave, duke parandaluar infiltrimin e substancave ndotëse në dheun përreth.

➤ Zhurma

Pajisjet teknologjike dhe aktivitetet transportuese mund të gjenerojnë zhurëm. Megjithatë, përdorimi i pajisjeve moderne me izolim akustik dhe kufizimi i orarit të punës do të minimizojnë ndikimet akustike në zonat përreth.

➤ **Flora dhe Fauna**

Zona e projektit nuk përmban habitate të mbrojtura ose specie me rëndësi të veçantë ekologjike. Ndikimet në florë dhe faunë konsiderohen minimale.

➤ **Ndikimet Sociale dhe Ekonomike**

Projekti pritet të ketë ndikime pozitive për komunitetin lokal përmes:

- Krijimit të vendeve të punës.
- Rritjes së aktivitetit ekonomik dhe fuqizimit të sektorit ndërtimor në Komunën e Pejës.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT, THËRRIMIT DHE SEPERIMIN E RËRËS DHE ZHAVORRIT

Para vendosjes për ndërtimin e impiantit për përpunimin, thërrimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, kompania “ENEX GROUP” SH.P.K. ka shqyrtuar disa alternativa të arsyeshme. Këto alternativa janë analizuar duke marrë parasysh faktorët mjedisorë, teknologjikë, ekonomikë dhe socialë, me qëllim që të sigurohet një zgjidhje e qëndrueshme dhe efikase për projektin. Më poshtë janë përshkruar disa alternativa të arsyeshme për ndërtimin e këtij impianti:

➤ **Afërsia me Burimet Natyrorë** - Lokacioni është me burime të pasura të rërës dhe zhavorrit, të cilët janë të nevojshëm për procesin e përpunimit dhe thërrimit. Ky është një faktor i rëndësishëm që zvogëlon kostot e transportit dhe mundëson efikasitet më të lartë në operacionet e prodhimit.

• **Përparsitë:**

- Kursimi i kostove të transportit.
- Sigurimi i burimeve të qëndrueshme për prodhim.

• **Mangësit:**

- Përdorimi i materialeve natyrore mund të krijojë ndotje lokale, nëse nuk menaxhohet siç duhet.

➤ **Qasja e Mirë:** Lokacioni ofron qasje të shkëlqyer në rrugë dhe infrastrukturë transporti, duke lehtësuar lëvizjen e materialeve dhe produkteve.

Përparësitë:

- Qasja e mirë në rrugë të shpejta redukton ndjeshëm kostot për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e materialit të përpunuar
- Mundësia për të lëvizur shpejt dhe me lehtësi mes impiantit dhe tregjeve të ndryshme rrit efikasitetin dhe shërbimin ndaj klientëve.
- Lehtësirat për transport e bëjnë operacionin më të shpejtë dhe më të besueshëm.

Mangësitë:

- Rrugët e ngarkuara mund të krijojnë vonesa, veçanërisht gjatë orëve të pikut, duke ndikuar në afatshmërinë e operacioneve.
- Rritja e aktivitetit industrial në zonë mund të kërkojë investime të mëtejshme në menaxhimin e trafikut për të siguruar sigurinë.

➤ **Burime Të Tjera:** Lokacioni ofron akses të lehtë në burime të tjera si energjia elektrike dhe ujë, që janë të domosdoshme për funksionimin e impiantit.

Përparësitë:

- Prania e burimeve të energjisë afër mund të rezultojë në kosto më të ulëta operative dhe një furnizim të qëndrueshëm energjie.

Mangësitë:

- Çdo problem me furnizimin e energjisë do të ndikojë në operacionet e impiantit, duke sjellë vonesa dhe humbje financiare.
- Nëse burimet nuk janë të zhvilluar në mënyrë adekuate, mund të kërkojnë investime të mëdha për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit në komunën e Pejës nuk është e mirë. Degradimi i tij është rezultat i ndërtimeve të pakontrolluara në zonat e mbrojtura të natyrës ashtu edhe jashtë tyre, infrastrukturës jo adekuate, shtimit të numrit të automjeteve dhe importimit të mjeteve motorike të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lart të sulfurit), deponimi i joadekuat i tyre, ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, akumulimit të plehrave urbane si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesës së riciklimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Për më tepër, degradimi ndodhë edhe nga mihjet sipërfaqësore dhe eksploatimi i zhavorrit nga një numër i konsideruar i kompanive. Gjithashtu edhe sektori i transportit është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit dhe në cilësinë e përbërësve të tij (ajrin, ujin dhe tokën). Ai po ashtu ndikon edhe në fragmentimin dhe degradimin e habitateve, ndryshimin e peizazhit, destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësore, ajrit dhe dheut dhe si pasojë shkakton dëmtim të resurseve natyror dhe humbje të tokës bujqësore.

5.1. Flora dhe Fauna

Gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, etj. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë, siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit etj., shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme.

Biodiversiteti - Komuna e Pejës, shquhet për shumëllojshmëri biologjike dhe të peizazhit. Zona e Bjeshkëve të Nemuna me relievin e thyer, burimet, ujëvarat dhe shpellat, strehon një shumëllojshmëri të habitateve dhe vegjetacionit, duke përfshirë specie endemike, sub-endemike dhe relikte të bimëve.

Krahas me pyjet e ahut dhe të lisit, Bjeshkët e Nemuna janë të pasura me pyje të gështenjës dhe pishave me karakter relikt dhe endemik - munika (*Pinus Leucodermis*), molika (*Pinus Peace*), pisha e bardhë dhe e zezë (*Pinus silvestris et nigra*), etj. Në Majen e Rusolisë rritet bima luleylli (*Lentopodium alpinum*), kurse në Gubavc forzitia (*Forsytia europea*).

Edhe fauna është jashtëzakonisht e pasur e përfaqësuar nga: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonj bardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*), etj. Lumenjtë janë të pasur me peshq veçanërisht me troftë. Gjithashtu janë prezentë edhe shumë lloje të ujëtokësorëve, reptilëve dhe zvarranikëve. Dallohen breshka e pyllit dhe e kënetave, bretkosat, hardhucat dhe gjarpërinjtë. Në Bjeshkët e Nemuna jetojnë edhe 129 lloje fluturash nga rendi *Lepidoptera* që e bëjnë rajonin ndër më të pasurit në Evropë për çka është identifikuar edhe si PBA (Primeary Butterfly Area). Për shkak të pasurisë së madhe me shpendë, si dhe kalimit të rrugëve migratore nëpër zonë, Bjeshkët e Nemuna janë konstatuar edhe si IBA rajone (IBA- Important Bird Areas)

5.2. Klima dhe Temperatura

Klima - e komunës së Pejës është e mesme - kontinentale me ndikim të asaj mesdhetare që depërton nëpër luginën e Drinit të Bardhë. Klima malore e regjionit të Rugovës karakterizohet me verën e nxehtë e dimrin e ftohtë dhe të gjatë. Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 11.6°C. Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 21.7°C , ndërsa e janarit - 0,5°C. Temperatura më e ulët e regjistruar është -23°C në dhjetor, dhe më e larta 35°C në gusht.

Figura 11. Të Dhënat Klimatologjike për Rajonin e Pejës

Të dhënat klimatologjike (m/s): 2020

Gjatësia gjeografike e st.: 20° 18' 18.30"

Lartësia mbidetare e st.: 498 m lmd

Gjerësia gjeografike e st.: 42° 39' 56.30"

Muaji	Temperaturat (°C)				Temperatura extreme (°C)						Shtypja e ajrit (hPa)	
	7	14	21	Tmes	Tmin	Tmax	Min	Dita	Max	Dita	Mes	
I	-1.0	3.3	-0.4	0.4	-2.8	3.7	-7.6	18/01	11.2	25/01	965.0	
II	3.1	9.7	4.0	5.2	1.1	9.9	-6.4	07/02	17.9	26/02	959.2	
III	4.9	11.6	5.9	7.1	3.1	11.9	-1.6	23/03	21.7	13/03	955.0	
IV	7.6	16.0	9.4	10.6	5.0	16.9	-2.4	01/04	26.0	19/04	954.5	
V	11.9	20.6	13.7	15.0	9.1	21.7	4.9	06/05	33.8	15/05	956.6	
VI	14.4	23.3	15.9	17.4	11.6	24.3	8.6	04/06	31.8	30/06	952.8	
VII	19.5	28.1	21.7	22.8	16.2	29.2	13.4	18/07	33.9	02/07	954.9	
VIII	19.0	26.3	22.5	22.6	17.1	27.9	12.6	06/08	31.8	31/08	955.5	
IX	16.2	23.8	20.4	20.2	13.9	24.9	7.6	27/09	29.6	13/09	957.9	
X	10.1	16.2	13.0	13.1	8.4	17.0	3.8	20/10	27.3	05/10	956.5	
XI	5.1	10.7	7.1	7.5	4.1	11.3	-3.1	27/11	20.4	04/11	965.1	
XII	2.5	6.1	4.4	4.3	1.7	6.4	-6.3	02/12	13.4	25/12	955.8	
Viti	9.4	16.3	11.5	12.2	7.4	17.1	-7.6	18/01	33.9	02/07	957.4	

Muaji	Lagështia e ajrit (%)				RD (h)	Mbulueshmëria me re (0-10)				Reshje shiu (mm)		Bora (cm)		
	7	14	21	Mes		Σ	7	14	21	Mes	Σ	Max	Dita	Tot
I	93	69	90	84	-	5.8	6.2	6.2	6.1	11.2	10.6	27/01	-	-
II	91	52	86	76	-	5.1	5.1	5.7	5.3	19.7	5.8	05/02	-	-
III	93	61	88	80	-	7.2	6.5	7.7	7.1	68.2	21.4	07/03	-	-
IV	94	56	90	80	-	5.7	5.6	6.3	5.8	49.8	28.0	22/04	-	-
V	93	57	86	79	-	7.5	7.7	7.6	7.6	74.8	24.5	21/05	-	-
VI	93	54	86	78	-	6.7	7.1	7.0	6.9	46.2	13.5	21/06	-	-
VII	84	51	79	71	-	6.0	5.5	6.9	6.1	46.0	23.9	27/07	-	-
VIII	77	53	63	64	-	6.6	6.4	6.7	6.6	99.7	17.4	01/08	-	-
IX	74	49	61	61	-	6.5	5.9	6.1	6.2	100.0	35.5	26/09	-	-
X	87	66	77	77	-	6.5	5.4	6.3	6.1	212.4	86.0	05/10	-	-
XI	84	66	79	76	-	5.3	5.3	5.5	5.4	0.0	0.0	01/11+	-	-
XII	93	82	90	88	-	8.9	8.8	9.2	9.0	226.2	68.5	31/12	-	-
Viti	88	60	81	76	-	6.5	6.3	6.8	6.5	954.2	86.0	05/10	-	-

Muaji	Ditë me							Shpëtiesa e erës (m/s)		Mbulueshmëria me re (0-10)		Reshje shiu (mm)		
	Temperaturat (°C)							> 6	> 8	< 2	> 8	≥ 0.1	≥ 1	≥ 10
	Tn ≤ -10	Tn < 0	Tn ≥ 20	Tx < 0	Tx ≥ 25	Tx ≥ 30								
I	0	24	0	6	0	0	0	0	0	0	11	2	1	1
II	0	7	0	0	0	0	2	2	2	2	8	8	6	0
III	0	4	0	0	0	0	1	0	0	2	15	10	10	2
IV	0	2	0	0	2	0	0	0	0	6	8	9	8	1
V	0	0	0	0	11	3	1	0	0	0	13	13	11	3
VI	0	0	0	0	13	1	1	1	0	0	7	13	9	1
VII	0	0	0	0	27	15	1	0	0	1	7	8	7	1
VIII	0	0	2	0	28	7	1	1	1	1	10	13	12	4
IX	0	0	0	0	16	0	0	0	0	6	13	7	7	4
X	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1	7	7	7	5
XI	0	4	0	1	0	0	0	0	0	3	9	0	0	0
XII	0	10	0	0	0	0	0	0	0	0	24	9	8	7
Viti	0	51	2	7	98	26	7	4	22	132	99	86	29	

5.3. Karakteristikat Hidrografike

Hidrografia - Rrafshi i Dukagjinit konsiderohet si treva më e pasur në Kosovë me resurse ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Komuna e Pejës ka një rrjet të zhvilluar hidrografik si lumenj,

Sipas Master Planit për Ujëra e Kosovës 1983-2000, potencialet më të mëdha të ujërave nëntokësore gjinden në rrafshin e Dukagjinit dhe shfrytëzimi i tyre bëhet kryesisht përmes puseve dhe burimeve të cilat edhe në Komunën e Pejës janë të shumtë.

Në zonën e Rugovës gjenden edhe liqenet glaciale si ai i Kuqishtës (1900 m), Liqeni i Drelajve (1800m), dhe 2 liqenet në Leqinat në lartësi prej 1860 m që shquhen për bukurinë e tyre dhe rrethinën e mbuluar me pyje të dendura pishe.

5.4. Lagështia Relative e Ajrit

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70,2%. Lagështia më e madhe mesatare e ajrit është në dhjetor, kurse më e vogla në qershor.

5.5. Vrantësimi dhe diellosja

Diellosja është e mirë, me një numër të mjaftueshëm ditësh me diell dhe 1958 orë në vit. Numri mesatar i ditëve të vrenjtura (75.9) dhe të kthjellëta (155. ditë) gjatë vitit është i volitshëm.

5.6. Të reshurat

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Mesatarja vjetore shumëvjeçare e të reshurave në pjesën kodrinore-fushore është rreth 800 mm, e në pjesën bregore-malore arrin mbi 1.025 mm. Pjesa më e madhe e këtyre reshjeve bie në dimër në formë bore, por edhe shiut.

5.7. Era

Erërat janë me shpejtësi të mesme 1.3 m/s, më të shpeshtat ato jug-perëndimore dhe perëndimore.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ky kapitull paraqet një analizë të detajuar të ndikimeve potenciale mjedisore që mund të rezultojnë nga realizimi i projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit të propozuar nga kompania “ENEX GROUP” SH.P.K.. Projekti është planifikuar të ndërtohet në parcelën kadastrale **P-71611018-00253-0**, zona kadastrale **Gllaviçicë**, Komuna e Pejës, dhe ka për qëllim sigurimin e një kapaciteti modern për përpunimin e agregateve inerte, në përputhje me kërkesat e tregut ndërtimor. Për shkak të natyrës së aktiviteteve të planifikuara, është e nevojshme të identifikohen dhe të analizohen ndikimet që mund të shkaktohen në komponentët kryesorë mjedisorë, për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe përputhshmëri me standardet mjedisore.

Aktivitetet që pritet të gjenerojnë ndikime përfshijnë operacionet e thërrmimit dhe separimit të materialeve, funksionimin e pajisjeve teknologjike dhe lëvizjen e mjeteve transportuese në zonën e impiantit. Këto procese janë burim potencial i emetimeve të pluhurit dhe gazeve, ndërsa aktivitetet e ndërtimit dhe operimit mund të shkaktojnë gjithashtu ndikime të përkohshme akustike dhe vibracione në zonat përreth. Për më tepër, për shkak të karakteristikave të terrenit dhe vendndodhjes së projektit, ndikimet mbi tokën, peizazhin dhe biodiversitetin janë konsideruar me rëndësi në vlerësimin e përgjithshëm.

Analiza është mbështetur në të dhëna për kapacitetin e projektuar të impiantit, karakteristikat teknologjike të pajisjeve, si dhe kontekstin mjedisor lokal. Ajo merr në konsideratë jo vetëm ndikimet e mundshme negative, por edhe përfitimet potenciale ekonomike dhe sociale që projekti do të sjellë për komunitetin lokal dhe rajonin përreth. Qëllimi është të sigurohet që ndikimet mjedisore të jenë të menaxhueshme përmes zbatimit të masave të parapara teknike dhe organizative, duke mundësuar një operim të sigurt dhe në harmoni me mjedisin.

6.1 Ndikimet në ajër

Gjatë realizimit të projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, parashikohen ndikime në cilësinë e ajrit që kryesisht lidhen me aktivitetet ndërtimore dhe proceset teknologjike të operimit.

Në fazën e ndërtimit, aktivitetet si gërmimi, nivelimi i terrenit, lëvizja e makinerive të rënda dhe transporti i materialeve ndërtimore pritet të gjenerojnë pluhur në ajër, i përbërë kryesisht nga grimca të pezulluara (PM₁₀ dhe PM_{2.5}). Ky pluhur mund të përhapet përkohësisht në zonën përreth, veçanërisht gjatë periudhave të motit të thatë dhe erërave që favorizojnë shpërndarjen e tij. Këto ndikime konsiderohen të përkohshme dhe do të pushojnë pas përfundimit të punimeve ndërtimore.

Në fazën e operimit, proceset e thërrmimit dhe separimit të agregateve përbëjnë burime të vazhdueshme të gjenerimit të pluhurit, sidomos gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të materialeve dhe lëvizjes së automjeteve transportuese në zonat manipuluese. Gjithashtu, pajisjet teknologjike dhe makineritë që përdorin karburant do të kontribuojnë në emetimin e gazrave serë si dioksidi i karbonit (CO_2), metani (CH_4) dhe oksidet e azotit (NO_x), si dhe ndotësve të tjerë të ajrit, përfshirë monoksidin e karbonit (CO) dhe hidrokarburet e pakombinuara (HC). Intensiteti i këtyre emetimeve pritet të jetë më i lartë në afërsi të burimeve brenda impiantit dhe të ulet me rritjen e distancës nga zona e aktivitetit.

6.2 Ndikimet në tokë

Projekti për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit parashikohet të ketë ndikime minimale në komponentin e tokës, për shkak të natyrës së aktivitetit dhe masave të parapara në dizajnin e impiantit.

Gjatë fazës së ndërtimit, ndryshimet në sipërfaqen e tokës do të kufizohen në zonën e përcaktuar të projektit dhe janë të lidhura me punimet përgatitore si nivelimi i terrenit dhe vendosja e infrastrukturës teknologjike. Lëvizja e mjeteve ndërtimore dhe transporti i materialeve mund të shkaktojnë një ngjeshje të përkohshme të shtresës sipërfaqësore të tokës, por këto ndikime mbeten të lokalizuara dhe nuk pritet të shkaktojnë dëmtime të ndjeshme në cilësinë e dheut.

Gjatë fazës së operimit, aktivitetet që lidhen me funksionimin e impiantit, si ruajtja dhe lëvizja e agregateve, nuk parashikohet të shkaktojnë ndikime të theksuara mbi tokën. Zona e impiantit do të jetë e pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për menaxhimin e rrjedhjeve sipërfaqësore dhe sistemin sedimentues, duke parandaluar përzierjen e substancave të mundshme ndotëse me shtresat e tokës përreth. Për shkak të këtyre elementeve të projektimit, ndikimet në tokë konsiderohen të kufizuara dhe të menaxhueshme gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.

6.3 Ndikimet në ujë

Gjatë realizimit të projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, parashikohen ndikime të kufizuara në komponentin ujor, të cilat lidhen me aktivitetet e ndërtimit dhe proceset e planifikuara pas vënies në funksion të impiantit.

Në fazën e ndërtimit, ndikimet janë të përkohshme dhe kryesisht të lidhura me reshjet atmosferike mbi sipërfaqet e hapura dhe lëvizjen e mjeteve të punës. Këto aktivitete mund të shkaktojnë rrjedhje sipërfaqësore që mbartin një sasi të vogël sedimenteve dhe grimcave inerte,

të cilat mund të përzihen me ujërat ekzistuese nëse nuk menaxhohen në mënyrë adekuate. Efekti i tyre është i kufizuar në kohë dhe nuk parashikohet të ketë ndikim të ndjeshëm në burimet ujore përreth.

Gjatë fazës së operimit, përdorimi i ujit është i orientuar kryesisht për spërkatjen e sipërfaqeve manipuluese dhe rrugëve të brendshme me qëllim kontrollin e pluhurit, si dhe për nevojat higjieno-sanitare të stafit dhe pastrimin periodik të pajisjeve teknologjike. Nga këto aktivitete mund të krijohen rrjedhje sipërfaqësore që përmbajnë sasi të vogla sedimente dhe substanca të pezulluara. Për të menaxhuar këto ujëra, kompania ka paraparë ndërtimin e një sistemi sedimentues, i cili do të lejojë sedimentimin e grimcave të ngurta dhe pastrimin e ujit përpara rikthimit në proces ose shkarkimit të tij në mënyrë të kontrolluar. Ky sistem është konceptuar për të garantuar mbrojtjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke e bërë ndikimin e përgjithshëm në komponentin ujor minimal dhe të menaxhueshëm

6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Realizimi i projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit pritet të ketë ndikime të kufizuara mbi peizazhin, florën dhe faunën përreth zonës së zhvillimit.

Gjatë fazës së ndërtimit, ndryshimet vizuale në peizazh do të jenë të lidhura kryesisht me aktivitetet ndërtimore, përfshirë hapjen e sipërfaqeve, vendosjen e pajisjeve teknologjike dhe lëvizjen e mjeteve ndërtimore. Këto ndikime vizuale janë të përkohshme dhe të lokalizuara brenda parcelës së projektit.

Në aspektin biologjik, zona ku do të ndërtohet impianti nuk karakterizohet nga një biodiversitet i lartë dhe nuk përmban habitate të mbrojtura ose specie të rralla të florës dhe faunës. Gjatë ndërtimit, mund të ketë një ndërprerje të përkohshme të aktiviteteve të faunës së zakonshme në zonë për shkak të zhurmës dhe lëvizjes së automjeteve, megjithatë këto efekte janë të lokalizuara dhe nuk pritet të kenë pasoja të qëndrueshme mbi ekosistemin.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet vizuale do të jenë më të qëndrueshme për shkak të ekzistencës së strukturave teknologjike dhe aktivitetit të impiantit. Ndërkohë, efektet mbi florën dhe faunën mbeten të kufizuara, pasi zona përreth nuk paraqet vlera të veçanta ekologjike dhe aktivitetet e impiantit zhvillohen brenda një zone të përcaktuar mirë dhe të kontrolluar.

6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Realizimi i projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit parashikohet të ketë ndikime të kufizuara mbi vendbanimet dhe

popullatën në zonat përreth. Gjatë fazës së ndërtimit, aktivitetet mund të shoqërohen me një rritje të përkohshme të nivelit të zhurmës dhe të pluhurit, të cilat janë të lokalizuara brenda kufijve të parcelës së projektit dhe nuk pritet të shkaktojnë shqetësime të theksuara për komunitetin lokal. Lëvizja e automjeteve ndërtimore në rrugët përreth mund të ndikojë gjithashtu në intensitetin e trafikut, por ky efekt është i përkohshëm dhe i lidhur vetëm me periudhën e ndërtimit.

Gjatë fazës së operimit, aktivitetet e impiantit do të zhvillohen brenda zonës së përcaktuar dhe me një menaxhim të kontrolluar të procesit teknologjik. Nivelet e zhurmës dhe pluhurit që gjenerohen gjatë përpunimit dhe lëvizjes së agregateve konsiderohen të moderuara dhe me ndikim të kufizuar në zonat e banuara përreth, për shkak të distancës së parcelës së projektit nga vendbanimet më të afërta. Për më tepër, projekti nuk përfshin aktivitete që gjenerojnë lloje të tjera të ndikimeve të drejtpërdrejta mbi popullatën, si ndotje të ujit ose emetime të substancave të rrezikshme.

Në përgjithësi, ndikimet mbi vendbanimet dhe popullatën konsiderohen minimale dhe të menaxhueshme, duke pasur parasysh masat e planifikuara për kontrollin e ndotjes dhe menaxhimin e proceseve operuese.

6.6 Ndikimet nga zhurma

Realizimi i projektit për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit pritet të gjenerojë nivele të moderuara zhurme, të cilat lidhen kryesisht me aktivitetet ndërtimore dhe proceset teknologjike të operimit.

Gjatë fazës së ndërtimit, burimet kryesore të zhurmës përfshijnë përdorimin e makinerive të rënda, transportin e materialeve dhe lëvizjen e automjeteve ndërtimore në dhe jashtë zonës së projektit. Këto ndikime konsiderohen të përkohshme dhe të kufizuara brenda kohës së zbatimit të punimeve, pa pasoja të qëndrueshme për zonat e banuara përreth.

Gjatë fazës së operimit, pajisjet teknologjike të impiantit dhe aktivitetet e ngarkim-shkarkimit të agregateve janë burimet kryesore të emetimeve akustike.

Tabela 3 Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës

Zhurma	Distanca e lejuar (metra)			
	10	50	100	500
90 db – Niveli i pajisjeve modele	59	45	39	25

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin prodhues të pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik, si dhe duke pasur parasysh se punohet vetëm

gjatë ditës, mund të konkludojm se impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit nuk ka ndikime negative të mëdha në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të seperacionit.

6.7.Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të procesit të operimit si:

- Lëndimet e punëtorëve gjatë kryerjes të aktiviteteve ndërtuese
- Shembja e tokës,
- Gjatë aktiviteteve transportuese,
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues,
- Mundësia e zjarrit, etj.

Mirëpo, gjatë aktivitetit të operimit, mekanizmi punues do të jetë gjithnjë i mirëmbajtur, dhe i monitoruar nga ekspertë të lëmive përkatëse.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundeshe qe mund te ndodhin me funksionimin e impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit nga kompania “ENEX GROUP” SH.P.K. janë:

- a) Në impiantin për përpunim, thërrmim dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit nuk do të ketë emetim të zhurmës së pa kontrolluar, e po ashtu edhe të dridhjeve, ndërsa sa i përket dritës nxehtësisë dhe rrezatimit kompania do të ketë shumë më lehtë të zhvilloj punën e sajë. Kompania gjithashtu ka planifikuar vendosjen e kontejnerëve për ndarjen e mbeturinave dhe rrjedhimisht nuk do të kemi ndotje as nga mbeturinat komunale.
- b) Impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit nga Kompania “ENEX GROUP” SH.P.K. ka planifikuar të gjitha masat për ruajtjen e shëndetit të njeriut si gjatë funksionimit të sajë, po ashtu Impianti mund ti përballoj fatkeqësive natyrore siç janë tërmetet, erërat dhe vërshimet. Nuk parashihet që të ketë ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut për arsye se të gjitha instalimet janë kontrolluar dhe po ashtu siguria në punë është parapare të jetë mjaft e lartë.
- c) Sa i përket zonave me rendësi të veçante, Impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit nuk rrezikon ndonjë zonë të veçante apo burim natyror.
- d) Ky Impiant nuk do të ketë ndikim të madh në natyrë për sa i përket gazrave serrë, për arsye se kamionët dhe të gjitha makineritë që do të përdoren do të jenë me pastrues gazra më të larte se Euro 4 te cilat lejohen për përdorim dhe se nuk kanë ndikim në cenueshmerinë e ambientit për rreth, po ashtu nuk kanë ndikim në ndryshime klimatike.
- e) Pasojat e mundshme mund të vijnë nga prishja e kamionëve, derdhja e karburanteve të makinave, nga sistemi elektro-energjetik, sa i përket pasojave ndërkufitare nuk ka fare pasoja, nuk bënë kurrfarë ndotje që të ndikoj në komunat fqinjë. Pasojat pozitive janë ato që kompania në fjalë pritët ti punësoj edhe më shumë punëtorë në administratë dhe prodhim. Ndërsa pasoja negative do te jeni minimale me zbatimin e masave qe dali nga ky raport.

Për sa i përket mbrojtjes se mjedisit kompania ka planifikuar te gjitha masat për mbrojtjen e Ajrit, ujit dhe tokës.

8. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të kompanisë. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.

- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhishë së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhishë së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS

Ky kapitull paraqet përshkrimin e detajuar të masave të planifikuara për shmangien, parandalimin, zvogëlimin ose eliminimin e ndikimeve negative që mund të rezultojnë nga aktivitetet e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit. Masat e propozuara janë hartuar në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe synojnë të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të impiantit duke ruajtur cilësinë e komponentëve kryesorë mjedisorë si ajri, uji, toka, biodiversiteti dhe shëndeti i popullatës përreth. Ato përfshijnë ndërhyrje teknike, organizative dhe operacionale që duhet të zbatohen gjatë të gjitha fazave të funksionimit të impiantit me qëllim minimizimin e rreziqeve mjedisore dhe sigurimin e pajtueshmërisë me normat mjedisore. Zbatimi i këtyre masave do të mundësojë që aktivitetet industriale të realizohen me ndikim sa më të ulët në mjedis dhe të kontribuojnë në një marrëdhënie të balancuar midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së resurseve natyrore.

9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të minimizuar ndikimet në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit, projekti ka paraparë zbatimin e një sërë masash teknike dhe organizative. Masat për kontrollin e këtyre ndikimeve përfshijnë:

- **Kontrolli i pluhurit** - Sipërfaqet e ekspozuara dhe rrugët manipuluese brenda zonës së impiantit do të spërkaten periodikisht me ujë me qëllim reduktimin e ngritjes së grimcave të pezulluara.
- **Reduktimi i emetimeve të gazrave** - Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve transportuese me standarde të larta mjedisore dhe mirëmbajtja e tyre periodike do të garantojë funksionim optimal dhe djegie të plotë të karburantit, duke reduktuar emetimin e gazrave ndotës si oksidet e azotit (NO_x), monoksidi i karbonit (CO) dhe hidrokarburet e pakombinuara (HC).
- **Barrierat mbrojtëse** - Vendosja e barrierave natyrore ose artificiale përgjatë kufijve të parcelës do të ndihmojë në kufizimin e përhapjes së pluhurit përtej zonës së impiantit.

9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të siguruar që aktivitetet e parashikuara për ndërtimin dhe operimin e impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit të mos shkaktojnë ndikime të konsiderueshme mbi komponentin ujor, projekti ka parashikuar një sërë masash teknike dhe organizative. Këto masa synojnë të minimizojnë rrezikun e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, të kufizojnë rrjedhjet e pakontrolluara sipërfaqësore gjatë fazës së ndërtimit

dhe të garantojnë trajtimin e ujërave potencialisht të ndotura gjatë operimit të impiantit. Masat për kontrollin e këtyre ndikimeve përfshijnë:

- **Menaxhimi i ujërave gjatë ndërtimit** - Gjatë fazës së ndërtimit, për të kufizuar ndikimet potenciale në ujërat sipërfaqësore, do të ndërmerren masa për kontrollin e rrjedhjeve sipërfaqësore dhe parandalimin e përhapjes së sedimenteve. Sipërfaqet e hapura do të menaxhohen përmes sistemit të përkohshëm të kanaleve kulluese, duke siguruar që ujërat e reshjeve të drejtohen në mënyrë të kontrolluar drejt zonave të përcaktuara dhe të mos përzihen me ujërat ekzistuese.
- **Ndërtimi i sistemit sedimentues** - Projekti parasheh ndërtimin e një sistemi sedimentues, i cili do të shërbejë për trajtimin e ujërave të rrjedhura nga aktivitetet e impiantit. Ky sistem do të mundësojë sedimentimin e grimcave të ngurta dhe pastrimin e ujit përpara rikuperimit për përdorim të brendshëm ose shkarkimit të tij në mënyrë të kontrolluar jashtë zonës së impiantit.
- **Reduktimi i konsumit të ujit dhe riciklimi** - Përdorimi i ujit do të kufizohet në spërkatjen e sipërfaqeve manipuluese për kontrollin e pluhurit dhe në nevojat higjieno-sanitare të stafit. Riciklimi i ujit të grumbulluar përmes sistemit sedimentues do të ndihmojë në uljen e konsumit të burimeve ujore të freskëta dhe në mbrojtjen e ekosistemeve përreth.
- **Menaxhimi i ujërave të rrjedhura sipërfaqësore** - Përmes kanalizimit të ujërave të sipërfaqësore drejt sedimentuesve, do të minimizohet mundësia e infiltrimit të ndotësve në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky sistem është projektuar për të mbrojtur cilësinë e ujërave përreth dhe për të siguruar që aktivitetet e impiantit të kryhen në përputhje me standardet mjedisore.

9.3. Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë

Për të siguruar që aktivitetet e ndërtimit dhe operimit të impiantit për përpunimin, thërrmimin dhe separimin e rërës dhe zhavorrit të mos shkaktojnë ndikime të konsiderueshme mbi komponentin e tokës, janë parashikuar një sërë masash parandaluese dhe mbrojtëse. Këto masa synojnë të ruajnë integritetin e shtresave sipërfaqësore të dheut, të parandalojnë erozionin dhe të shmangin ndotjen nga rrjedhjet sipërfaqësore ose derdhjet aksidentale të materialeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit jetësor të projektit.

- **Menaxhimi i sipërfaqeve të ekspozuara** - Gjatë fazës së ndërtimit, punimet do të kufizohen brenda zonës së përcaktuar të projektit për të shmangur ndërhyrjen në zonat përreth. Sipërfaqet e hapura do të trajtohen në mënyrë që të minimizohet erozioni dhe

transportimi i sedimenteve nga ujërat e reshjeve, duke përdorur kanale kulluese të përkohshme dhe barrierat mbrojtëse.

- **Parandalimi i ndotjes së tokës nga aktivitetet operuese** - Gjatë operimit të impiantit, ruajtja dhe menaxhimi i materialeve inerte do të kryhet në hapësira të dedikuara dhe të mbuluara me shtresa të papërshkueshme për të parandaluar infiltrimin e mundshëm të substancave në tokë. Transporti dhe manipulimi i agregateve do të bëhet në mënyrë të kontrolluar për të shmangur derdhjet aksidentale dhe shpërndarjen e materialeve jashtë zonës teknologjike.
- **Sistemi i menaxhimit të ujërave sipërfaqësore** - Sistemi i planifikuar për mbledhjen dhe drejtimin e ujërave të rrjedhura drejt sedimentuesve do të sigurojë që uji i përzier me grimca inerte të mos shkarkohet në mënyrë të pakontrolluar dhe të mos ndikojë në cilësinë e shtresave të tokës.
- **Monitorimi periodik** - Gjatë gjithë fazës së operimit, do të realizohet monitorim periodik i gjendjes së tokës brenda dhe përreth zonës së impiantit për të identifikuar dhe adresuar në kohë çdo ndryshim potencial në karakteristikat fiziko-kimike të saj.

9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma

Zvogëlimi i ndikimeve nga zhurma është një aspekt kyç për operimin e impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit. Kjo është e rëndësishme për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e popullatës lokale si dhe për të minimizuar shqetësimet për faunën.

Më poshtë janë disa masa efektive për zvogëlimin e ndikimeve nga zhurma:

- Vendosja e një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm të niveleve të zhurmës për të siguruar që zhurmat të mbahen brenda kufijve të pranueshëm dhe për të identifikuar shpejt çdo problem.
- Informimi i komunitetit për oraret e punës, aktivitetet e parashikuara që mund të shkaktojnë zhurmë, dhe zbatimi i një plani për adresimin e ankesave dhe shqetësimeve të banorëve.

9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Për të siguruar mbrojtjen e komponentëve natyrorë dhe ruajtjen e karakterit vizual të zonës përreth, projekti ka parashikuar një sërë masash që synojnë të minimizojnë ndërhyrjet në peizazh dhe ndikimet mbi florën dhe faunën lokale. Këto masa janë hartuar për të garantuar që aktivitetet ndërtimore dhe operuese të zhvillohen në përputhje me standardet mjedisore dhe të

kontribuojnë në integrimin harmonik të impiantit me mjedisin rrethues. Masat për kontrollin e këtyre ndikimeve përfshijnë:

- Kryerja e një vlerësimi të detajuar të florës lokale për të identifikuar dhe mbrojtur speciet e rrezikuara dhe habitatet e tyre.
- Kufizimi i zonës së ndërtimit për të minimizuar ndikimin në vegetacionin natyror.
- Rikthimi i vegetacionit të dëmtuar pas përfundimit të impiantit për përpunim , thërrmim dhe seperim të rërës dhe zhavorrit, në mënyre që të sigurojë që ekosistemi të rikthehet në gjendje të mëparshme.
- Planifikimi i korridoreve ekologjike në dizajnin e impiantit për të siguruar që kafshët të kenë rrugë të sigurta për lëvizje.

9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të siguruar që aktivitetet e ndërtimit dhe operimit të impiantit të mos krijojnë shqetësime të theksuara për komunitetin lokal, projekti ka parashikuar një sërë masash teknike dhe organizative. Aktivitetet ndërtimore do të planifikohen dhe koordinohen në mënyrë që të minimizohet zhurma dhe pluhuri që mund të gjenerohet, duke kufizuar punimet më intensive në orët e ditës dhe duke shmangur ndërhyrjet jashtë orarit të zakonshëm të punës. Gjithashtu, rrugët e brendshme të impiantit do të mirëmbahen në mënyrë që të reduktohet ngritja e pluhurit nga lëvizja e automjeteve transportuese, ndërsa sistemet teknologjike do të jenë të pajisura me mekanizma për kontrollin e emetimeve akustike dhe të pluhurit. Për të mbrojtur zonat e banuara më të afërta, është parashikuar vendosja e barrierave mbrojtëse natyrore ose artificiale përgjatë kufijve të parcelës, të cilat do të ndihmojnë në pengimin e përhapjes së pluhurit dhe zhurmës përtej zonës së aktivitetit. Komunikimi me komunitetin lokal do të mbahet aktiv gjatë gjithë periudhave të ndërtimit dhe operimit për të adresuar në kohë çdo shqetësim që mund të lindë dhe për të siguruar që operacionet të zhvillohen në harmoni me interesat e popullatës përreth.

9.7. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Për të minimizuar rreziqet dhe për të parandaluar aksidentet mjedisore në impiantin e “ENEX GROUP” SH.P.K është thelbësore të zbatohen masa të qarta dhe efektive. Më poshtë janë disa nga këto masa:

- **Vlerësimi i Rreziqeve:** Kryerja e një analize të detajuar të rreziqeve për të identifikuar potencialet e aksidenteve dhe ndikimeve mjedisore. Identifikimi i burimeve potenciale të rrezikut si substancat kimike, energjia elektrike dhe makineritë e rrezikshme.

- **Zhvillimi i Planit të Emergjencës:** Hartimi i një plani emergjence për situata si rrjedhjet e lëndëve kimike, zjarret ose ndotjet. Kryerja e stërvitjeve të rregullta për stafin për të siguruar që ata të jenë të gatshëm për të reaguar në situata emergjente.
- **Pajisje Mbrojtëse Personale (PPE):** Sigurimi që të gjithë punonjësit të përdorin pajisje mbrojtëse personale si helmetat, dorezat dhe maskat, për të reduktuar rreziqet nga lëndët e rrezikshme. Ofrimi i trajnimeve për stafin mbi përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse.
- **Monitorimi i Ambientit:** Vendosja e sistemeve për monitorimin e ndotjes, nivelit të zhurmës dhe kushteve mjedisore për të identifikuar rreziqet potenciale. Krijimi i një mekanizmi për raportimin e rreziqeve dhe aksidenteve nga stafi dhe komuniteti.
- **Trajnimi dhe Edukimi:** Ofrimi i trajnimeve të rregullta për stafin në lidhje me sigurinë në punë, procedurat e emergjencës dhe menaxhimin e rreziqeve. Informimi i banorëve mbi procedurat e sigurisë dhe masat që po merren për të mbrojtur mjedisin.

Zbatimi i këtyre masave është thelbësor për të siguruar mbrojtjen e punonjësve, mjedisit dhe komunitetit nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore. Një qasje proaktive dhe e organizuar do të ndihmojë në krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qëndrueshëm për të gjithë.

9.8. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të impiantit për përpunim, thërrmim dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit të kemi edhe mbeturina komunale të cilat krijohen nga punëtorët dhe blerja e produkteve të reja nga punëtorët, ushqimi dhe blerja e produkteve të tjera. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave kompania ka marrëveshje me kompaninë rajonale të mbeturinave të komunës së Pejës.

Tabela 4 Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e Rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për Deponim të mbeturinave
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Për mbetje të mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do të trajtohen komfor legjisllacionit

adekuat për menaxhim me mbeturina.

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me impiantin e përpunimit, thërrmimit dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe raportimi janë aspekte thelbësore të menaxhimit mjedisor për ndërtimin dhe operimin e një impianti për përpunim, thërrmim dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit. Këto procese ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë me rregulloret mjedisore, në vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mjedisore. Më poshtë është një përshkrim i metodave dhe praktikave për monitorimin dhe raportimin mjedisor.

a. Monitorimi i Ajrit

- **Monitorimi i Cilësisë së Ajrit:** Ky monitorim do të kryhet nga kompania e licencuar për matje të emisioneve në ajër.
- **Matja e Emetimeve nga Pajisjet dhe Makineritë:** Monitorimi i emetimeve nga makineritë dhe pajisjet që përdoren gjatë operimit të impiantit.

b. Monitorimi i Ujit

- **Monitorimi i Cilësisë së Ujit:** Kryerja e analizave të rregullta të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për të ndjekur nivelet e ndotjes dhe për të identifikuar burimet e mundshme të ndotjes.

c. Monitorimi i Zhurmës

- **Matja e Nivelit të Zhurmës:** Përdorimi i pajisjeve për matjen e niveleve të zhurmës në dhe përreth impiantit për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe për të minimizuar shqetësimet për banorët lokalë.
- **Rishikimi Periodik:** Rishikimi i rregullt i politikave dhe procedurave mjedisore për të siguruar që ato janë të azhurnuara dhe përputhen me praktikën më të mira dhe kërkesat rregullatore.

Monitorimi dhe raportimi i pasojave mjedisore nga operimi i impiantit, janë thelbësore për të siguruar që ndikimet negative të minimizohen dhe që impianti të operojë në përputhje me standardet dhe rregulloret mjedisore. Kjo kërkon një qasje të integruar që përfshin vendosjen e

sistemeve të monitorimit, përgatitjen e raporteve të detajuara, vlerësimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e praktikave mjedisore.

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë sajë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Impianti i përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit është një zgjidhje thelbësore për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Përmes procesit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit, këto materiale shndërrohen në fraksione të përdorshme në ndërtimtari, duke kontribuar në ruajtjen e burimeve natyrore dhe reduktimin e mbetjeve.

12.1. Ndikimet Mjedisore dhe Masat Zbutëse

Megjithëse projekti sjell përfitime të rëndësishme për sektorin e ndërtimit dhe ekonominë lokale, operimi i implantit mund të shoqërohet me ndikime potenciale mjedisore si ndotja e ajrit, tokës, ujit, gjenerimi i zhurmës dhe ndryshime në peizazh, florë dhe faunë. Për të adresuar këto aspekte, janë përcaktuar masa specifike zbutëse që përfshijnë:

- **Ajri:** Reduktimi i gjenerimit të pluhurit përmes spërkatjes periodike të sipërfaqeve me ujë, duke minimizuar përhapjen e grimcave të pezulluara në zonat përreth.
- **Toka:** Menaxhimi i kontrolluar i mbetjeve inerte dhe zbatimi i masave për parandalimin e erozionit në zonat e ekspozuara.
- **Uji:** Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave dhe parandalimi i rrjedhjeve potencialisht të kontaminuara përmes sistemit sedimentues të parashikuar në projekt.
- **Zhurma:** Përdorimi i pajisjeve teknologjike me izolim akustik dhe vendosja e barrierave mbrojtëse për të kufizuar përhapjen e zhurmës jashtë kufijve të parcelës.
- **Peizazhi, flora dhe fauna:** Ruajtja e habitateve natyrore jashtë zonës së projektit dhe mbjellja e gjelbërimit kompensues në zonat e përcaktuara për rehabilitim.
- **Vendbanimet dhe popullata:** Sigurimi i transparencës me komunitetin lokal, kufizimi i zhurmës dhe pluhurit gjatë operimit dhe menaxhimi i trafikut për të shmangur shqetësimet në zonat e banuara.

12.3. Përfitimet

Impianti jo vetëm që ndihmon në proceset e ndryshme të ndërtimit, gjithashtu kontribuon në ekonominë lokale duke krijuar vende pune dhe duke promovuar praktika të qëndrueshme. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit efikas dhe të qëndrueshëm të mbetjeve nga rëra dhe zhavorri dhe një kontribut të vlefshëm për mbrojtjen e mjedisit.

Andaj, Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit të impiantit të përpunimit, thërrmimit dhe seperimin të rërës dhe zhavorrit vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin lokal janë minimale dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se të dhënat e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë të mjaftueshme dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për **Pëlqim Mjedisor** sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit “ENEX GROUP” SH.P.K nga Komuna e Pejës.

13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

TABELA E KOST – BENEFITE E INVESTIMIT NË IMPIANTIN E PËRPUNIMIT, THËRRIMIT DHE SEPERIMIT TË RËRËS DHE ZHAVORRIT, “ENEX GROUP” SH.P.K.		
Nr.	Pajisja/Pasuria	Çmimi i Vlerësuar (€)
1	Bunkeri i rërës dhe zhavorrit ($V = 10 \text{ m}^3$)	16,000
2	Transportuesi horizontal mbledhës – Dozatori	12,000
3	Transportuesi i pjerrët furnizues	14,000
4	Sita me pesë fraksione granulometrike	29,000
5	Elevatori rotork me kova	10,000
6	Transportuesit për fraksionet e ndara (5 copë)	33,000
7	Tabela komanduse e separacionit	6,500
8	Pompa e ujit ($P = 18.5 \text{ kW}$)	5,500
9	Trafostacioni elektrik (250 kVA)	23,000
10	Ndërtimi i infrastrukturës dhe rrugëve	39,500
	Totali	188,500.0

“ENEX GROUP” SH.P.K.



14. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- [Kërko dhe paraqit - KGP](#)
- [Pejë to 42.6352434, 20.4137195 - Google Maps](#)
- [Plani Zhvillimor Komunal i Pejës 2020-2028 \(rks-gov.net\)](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)
-